



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4850 prot.

Himarë, më 19.11 2021

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së muajit nëntor të Këshillit të Bashkisë Himarë

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e premte, datë **26.11.2021**, në orën **10.00**, në sallën e godinës së stadiumit "Petro Ruci" të Himarës, do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Himarë, për muajin nëntor 2021, e thirrur nga kryetari i këtij këshilli, në bazë të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 53, pika 4, duke respektuar rregullat për mbrojtjen nga infektimi me "COVID-19". Mbledhja do të ketë këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e disa shtesave në prioritetet për investime të Bashkisë Himarë për vitin 2022".
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Himarë për vitin 2022"
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë, për vitin 2022"
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31 tetor 2021, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike".
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30 nëntor 2021, nga fondet e Bashkisë Himarë"
6. Të ndryshme

NËNKRYETAR

Mirka Gjiçali

